



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Drejtoria e Arsimit

04 Nr. 610/01-2474/23

Datë, 22.08.2023

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L- 032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 22/2013 për numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës shpallë:

KONKURS

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e Dhjetë (10) në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe Shkollën Profesionale "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka" në Kaçanik për vitin shkollor 2023/2024 – Afati i Gushtit

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt
Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10, në gjimnaz dhe në shkollë profesionale, për vitin shkollor 2023/24, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç. Nxënësit të cilët e kanë mbaruar klasën e 9 jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.
2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim
Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10 në gjimnaz dhe shkollën profesionale duhet të paraqesin këto dokumente:
Fletëparaqitja (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
Dëftesa origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe Ekstrakti i lindjes.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaz dhe shkollë profesionale për vitin shkollor 2023/24, bëhet më datën 22,23 dhe 24 gusht 2023 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8:00-16:00.

Rezultatet shpallen në shkollat përkatëse me datën 25.08.2023, ndërsa kthimi i dokumenteve për nxënësit të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 25.08.2023 dhe 28.08.2023. Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë Drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHTI -it Komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10 duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (40 %) 40 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (20 %) 20 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (40 %) 40 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

Shih Vendimin e MASHTI-it të datës 14.07.2023, për kushtet, kriteret dhe afatet e regjistrimit të nxënësve në klasat e X (dhjeta) për vitin shkollor 2023-2024

Regjistrimi në klasat e X – Afati i Gushtit 2023

IAAP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka"- KAÇANIK

Nr.	DREJTIMI	PROFILI	Nr. i paraleleve	Nr.i nxën të planif	Nr i nx të regj	Vende të lira
1.	ELEKTROTEKNIKË	- Elektronikë industriale	1 paralele	32 nxënës	2	30
		- Informatikë	1 paralele	32 nxënës	10	22
		- Instalues elektrik	1 paralele	24 nxënës	13	11
2.	EKONOMI	- Kontabilitet dhe tatime	1 paralele	32 nxënës	5	27
		- Tregti me shumicë dhe pakicë	1 paralele	32 nxënës	2	30

3.	MAKINERI	- Instalues i ngrohjes, klimatizimit, ujësjellësit e kanalizimit	2 paralele	48 nxënës	17	31
		- Automekanik	1 paralele	32 nxënës	5	27
		- Metalpunues	1 paralele	24 nxënës	2	22
5.	JURIDIK	- Nëpunës i administratës dhe shërbimeve të zyrës	1 paralele	32 nxënës	5	27
Gjith sej	4	9	10	288	61	227

Gjimnazi "Skënderbeu" - KAÇANIK

Nr.	DREJTIMI	Nr. i paraleleve	Nr. i nxënës të planifikuar	Nr i nx të regjistruar	Vende të lira
1.	Shkenca Natyrore	4	128	74	54
2.	Shkenca Shoqërore- Gjuhësore	3	96	53	43
Gjit hsej	2	7	224	127	97

Drejtori i DAK
Z. Zaim Doda

